



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

31 Janar 2023, Prishtinë

FTESË PËR APLIKIM

**PËR ANËTAR TË KOMISIONIT VLERËSUES PËR PROJEKTET E OJQ-VE NGA
FUSHA E SHËRBIMEVE SOCIALE DHE FAMILJARE**

Bazuar në Rregulloren e Ministrisë së Financave Nr- 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, në Nenin 8, paragrafi 3.2 parasheh që pjesë e çdo Komisioni Vlerësues për vlerësimin e projekt propozimeve të OJQ-ve të pranuar sipas thirrjes publike duhet të jenë dy përfaqësues nga grupi i ekspertëve të jashtëm, duke përfshirë një përfaqësues të OJQ-ve.

Për këtë qëllim MD fton të gjithë të interesuarit që të aplikojnë për të qenë pjesë në cilësinë e anëtarit të Komisionit Vlerësues për të vlerësuar projekt propozimet e dorëzuara nga OJQ-të sipas thirrjes publike nga fusha e shërbimeve sociale të datës 31.01.2023 të publikuar nga Ministria e Drejtësisë.

Të gjithë kandidatët të cilët nuk janë nën hetime apo me precedent penal dhe që kanë përvojë në shoqërinë civile me përparësi nga OJQ-të që merren me fushën e shërbimeve sociale apo fusha të ngjashme, u mundësohet të aplikojnë për pjesëmarrje në Komisionin Vlerësues në cilësinë:

- Një përfaqësues nga OJQ-të;
- Një përfaqësues në cilësinë e ekspertit.

Të drejtë aplikimi kanë

- Të punësuarit në organizatat jo-qeveritare aktive në Republikën e Kosovës;
- Ekspertë të pavarur, cilët kanë të paktën 5 vite përvojë pune që ndërlidhet me administratën publike, hartimin dhe menaxhimin e projekteve në fushën e shërbimeve sociale apo fusha të ngjashme.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte

- Duhet të kenë të kryer së paku nivelin e studimeve bachelor;
- Të kenë të paktën 5 vite përvojë pune;
- Të kenë përvojë në projektet e OJQ-ve;
- Të mos jenë të emëruar politikë, shërbyes civil apo pozita të ngjashme në administratën shtetërore.

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente

- Një letër motivimi;
- Një CV të përditësuar;
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës;
- Të punësuarit në OJQ duhet të dorëzojnë një letër nominimi nga Udhëheqësi i OJQ-së në të cilën aplikuesi është i punësuar apo angazhuar.

Aplikimi mund të bëhet përmes e-mail: www.md@rks-gov.net deri me datën **22.02.2023**.

Aplikimin mund ta bëni po ashtu, duke dorëzuar një kopje fizike të dokumentacionit të kërkuar në Ministrinë e Drejtsisë, Ndërtesa e Qeverisë Luan Haradinaj, pn. Ndërtesa e ish Rilindjes 10 000 Prishtinë, Zyra e Arkivit në MD.

MD do të vlerësoj të gjitha aplikacionet e pranuar dhe kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e përcaktuara përmes kësaj ftese publike do të jenë pjesë e Komisionit Vlerësues të thirrjes publike nga fusha e shërbimeve sociale të datës **31.01.2023** të publikuar nga Ministria e Drejtsisë.